



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA SUPREME**

---

Numri i lëndës: 2022:250374

Datë: 14.04.2023

Numri i dokumentit: 04191294

Pml.nr.158/2023

**NË EMËR TË POPULLIT**

Gjykata Supreme e Kosovës – kolegji i përbërë nga gjyqtarët, Valdete Daka kryetare e kolegjit, Agim Maliqi dhe Rasim Rasimi anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Qefsere Berisha, në çështjen penale kundër të pandehurit I. G. për shkak të veprës penale vrasja e rëndë nga neni 173 par. 1 nën par. 1.3 dhe 1.4 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtëses së të pandehurit, paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, PPKR.nr.644/2022 të datës 23.2.2023 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PNI.nr.263/2023 të datës 16.3.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më 14.4.2023, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtëses së të pandehurit I. G., paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, PPKR.nr.644/2022 të datës 23.2.2023 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PNI.nr.263/2023 të datës 16.3.2023.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, me aktvendimin PPKR.nr.644/2022 të datës 23.2.2023, të pandehurit I. G. për shkak të veprës penale vrasja e rëndë nga neni 173 par. 1 nën par. 1.3 dhe 1.4 të KPRK, ia ka vazhduar masën e paraburgimit për 2 (dy) muaj ashtu që sipas këtij aktvendimi paraburgimi do t'i zgjasë nga data 25.2.2023 deri

më datën 25.4.2023. Masa e paraburgimit i është vazhduar, konform dispozitës së nenit 184 par.1 nënpar.1.1 e 1.2 pika 1.2.1 dhe 1.2.3 lidhur me nenin 188 të Kodit të Procedurës Penale (KPP).

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktvendimin PNI.nr.263/2023 të datës 16.3.2023 e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtëses të të pandehurit dhe e ka vërtetuar aktvendimin e shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësja e të pandehurit I. G. av. Myrvete Hashani Jashari nga Prishtina, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që aktvendimet e kundërshtuara të anulohen ose të ndryshohen dhe i pandehuri të lirohet nga masa e paraburgimit ose ndaj tij të caktohet ndonjëra nga masat më të buta nga neni 173 i KPP.

Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.III.nr.67/2023 të datës 13.4.2023, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtëses së të pandehurit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par. 1 lidhur me nenin 436 par. 1 të KPP, vlerësoi pretendimet në kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se:

- Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e pabazuar.

Mbrojtësja e të pandehurit në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë thekson se aktvendimet e kundërshtuara janë marrë me shkelje të dispozitave të procedurës penale ngase dispozitivi i aktvendimeve është në kundërshtim me arsyetimin e dhënë, nuk janë dhënë arsye dhe fakte relevante në këtë çështje penale juridike. Gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë e po ashtu edhe prokuroria nuk kanë arritur që të ofrojnë prova bindëse për vazhdimin e masë së paraburgimit. gjykatat nuk kanë vlerësuar se i pandehuri ka shprehur gatishmëri që në çdo moment dhe kohë të jetë i gatshëm që ti përgjigjet ftesës së gjykatës, ai vet është lajmëruar në polici dhe se nuk ka bërë asnjë veprim të fshehjes andaj edhe nuk ekziston rreziku i ikjes, kjo edhe për shkak të moshës së tij të shtyrë. I pandehuri më parë nuk ka rënë ndesh me ligjin, dhe se është dashur që të merren edhe rrethana në favor të prezumimit të pafajësisë ndaj të pandehurit. Nuk është vërtetuar dashja e të pandehurit apo ndonjë rrethanë tjetër, po ashtu edhe arsyetimi se kjo dukuri është bërë e shpeshtë, nuk mund të përgjithësohet dhe e gjithë përgjegjësia e kryerësve të këtyre veprave të bie në barrë të këtij të pandehurit.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, në këtë çështje penalo juridike, nga kallëzimi penal numër të rastit 2022-AB-3247 i datës 25.11.2022, aktvendimit për fillimin e hetimeve si dhe shkresave tjera në lëndë rezulton se ekziston dyshimi i bazuar se të pandehurit e ka kryer veprën penale për të cilën dyshohen dhe për të cilat janë duke u zhvilluar hetimet, me çka janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 184 par.1 nën par.1.1 të KPP për caktimin e paraburgimit, kurse a do të argumentohen këto fakte do të vlerësohet në fazat e mëtejme të procedurës penale pasi që procedura penale është në fazën e hetimeve.

Kjo Gjykatë vlerëson se ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit konform nenit 184 par.1 nën par.1.2 pika 1.2.1 të KPP, ngase me lëshimin e të pandehurit në liri ekziston rreziku i fshehjes apo arratisjes me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale duke pasur parasysh faktin se vepra penale për të cilën dyshohet i pandehuri është e natyrës mjaftë të rëndë, me çka do të pamundësohej zhvillimi i rregullt i procedurës penale.

Gjithashtu kjo Gjykatë vlerëson se ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit edhe konform nenit 184 par.1 nënpar.1.2 pika 1.2.3 të KPP, duke pasur parasysh peshën e rëndë të veprës penale, mënyrën dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, e si pasojë ka ndërruar jetë një person – bashkëshortja e të pandehurit, tregojnë rrezikun se i pandehuri mund të përsërisë veprën e njëjtë penale apo ndonjë vepër tjetër të ngjashme penale.

Andaj nga arsyet e mësipërme, kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk ka shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale, sepse si gjykata e shkallës së parë e po ashtu edhe ajo e shkallës së dytë kanë bërë vlerësimin dhe arsyetimin e duhur, dhe në bazë të vlerësimit të tillë, kanë nxjerrë aktvendimet duke dhënë edhe arsyet të mjaftueshme, të cilat si të drejta i pranon edhe kjo Gjykatë.

Nga sa u parashtrua më lartë e në kuptim të nenit 437 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË  
Pml.nr.158/2023, më 14.4.2023

Bashkëpunëtorja profesionale  
Qefsere Berisha

Kryetarja e kolegjit,  
Valdete Daka